

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6800  
E enjte, 12 janar 2023  
çmimi 0.40 €

Aliu: Deri më 2030 presim që 30 për qind e veturave në Kosovë të jenë elektrike



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KËSHILLTARI I LARTË I DEPARTAMENTIT AMERIKAN TË SHETIT, DEREK CHOLLET, KA TAKUAR NË PRISHTINË KRERËT SHTETËTORË TË KOSOVËS

## KOSOVA: ANGAZHIMI I SHTUAR I SHBA-së NË DIALOG, VENDIMTAR PËR TË SIGURUAR REZULTAT TË SUKSESSHËM



Këshilltari i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, së bashku me të dërguarin e ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe ambasadorin amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka takuar

përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës me të cilët ka diskutuar për fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së dhe për procesin e dialogut me Serbinë. Përfaqësuesit e

institucioneve të Kosovës kanë theksuar se angazhimi i shtuar amerikan në dialog me Serbinë është vendimtar për të siguruar rezultat të suksesshëm në dobi të qytetarëve të Republikës së Kosovës

ME EKSPOZITË FOTOGRAFISH DHE PROGRAME ARTISTIKE, KUJTOHET EDICIONI I PARË I 'FLAKËS SË JANARIT'



PDK-ja KËRKON SHKARKIMIN E AMBASADORIT BERISHAJ

KURTI: PROJEKTLIGJI PËR INVESTIME TË QËNDRUESHME KA SYNIM MBROJTJEN DHE TËRHEQJEN E INVESTIMEVE

### EKONOMI



EKONOMIA GLOBALE PARASHIKOHET TË RRIKET PËR 1.7 PËR QIND NË VITIN 2023

### SPORT



PRISHTINA BËN DY GODITJE BRENDA DITËS

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Zelensky ua heq shtetësinë katër ligjvënësve ukrainas

KIEV, 11 JANAR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky njoftoi se ka revokuar shtetësinë për katër ligjvënës ukrainas të dyshuar për tradhti, tre prej të cilëve janë pjesë e një partie të ndaluar pro-ruse.

Shtetësia iu hoq Andriy Derkach, Taras Kozak, Renat Kuzmin, dhe Viktor Medvedchuk.

Sipas presidentit ukrainas, kjo u bë "bazuar në materialet e përgatitura nga Shërbimi i Sigurisë i Ukrainës dhe nga Shërbimi Shtetëror i Sigurisë".

Të paktën tre prej këtyre personave gjenden jashtë vendit dhe që të gjithë janë nën procedime ligjore nën dyshimet për tradhti qëkur Rusia nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës në fund të shkurtit të

vitit të kaluar. "Nëse përfaqësuesit e zgjedhur të popullit zgjedhin të shërbejnë jo për popullin e Ukrainës, por për vrasësit që kanë ardhur në Ukrainë, veprimet tona do të jenë të përshtatshme", tha Zelensky gjatë një adresimi në orët e vona të 10 janarit.

Ai shtoi se këto nuk do të jenë vendimet e fundit të këtij lloji. Derkach, Kozak, Kuzmin, dhe Medvedchuk ishin zgjedhur deputetë në Parlamentin ukrainas, nga partia Platforma Opozitare për Jetë. Kjo parti aktualisht është e ndaluar në Ukrainë.

Derkach ka qenë deputet për më shumë se dy dekada, por hetuesit besojnë se ai ka pranuar më shumë se gjysmë milioni dollarë nga agjencitë e

zbatimit të ligjit dhe të inteligjencës së Rosisë "për aktivitete subversive kundër Ukrainës gjatë viteve 2019-2022". Ai nuk ka marrë pjesë në asnjë seancë plenare që nga shkurti i vitit të kaluar.

Politikani Medvedchuk, kumbara i bijës i presidenti rus, Vladimir Putin, ishte arrestuar në prill dhe i ishte dorëzuar Rosisë në shtator gjatë një këmbimi të të burgosurve.

Ndërkaq, Kozak është larguar nga Ukraina më 2021.

Hetuesit kanë thënë se ligjvënësi i katërt, Kuzmin, "ka publikuar në medie materiale propaganduese në dëm të Ukrainës".

Asnjëri nga këta katër ligjvënës nuk i është përgjigjur publikisht këtij vendimi të Zelenskyt.



## Gjashtë të plagosur nga një sulm me thikë në Paris



PARIS, 11 JANAR - Një person ka plagosur me thikë gjashtë veta në një sulm të paprovokuar në stacionin e trenave Gare du Nord në Paris mëngjesin e së mërkurës, më pas i dyshuari u qëllua nga policia, tha ministri i Brendshëm francez.

I dyshuari sulmoi disa persona, përfshirë një zyrtar policor, me "një armë të mprehtë" rreth orës 06:43, tha ministri i Brendshëm Gerald

Darmanin. Ai tha se sulmuesi, identiteti i të cilit nuk u bë publik, aktualisht gjendet në spital dhe po "lufton për jetë".

Disa pasagjerë dhe një polic kufitar janë në mesin e të plagosurve, thanë zyrtarët.

Një polic u ther me thikë në shpinë nga sulmuesi, por ai shpëtoi pasi kishte të veshur një jelek antiplumb, tha Darmanin.

Sipas autoriteteve, një prej të

plagosurve është në gjendje më serioze dhe është duke u trajtuar në spital.

Videot nga Gare du Nord, një prej stacioneve më të frekuentuar të trenave në Paris, shfaqën dhjetëra policë pranë hyrjes së stacionit. Autoritetet e rendit, po ashtu, kanë bllokuar hyrjen në këtë stacion.

Deri më tani autoritetet nuk kanë treguar se cili mund të jetë motivi i këtij sulmi.

## Libri i Princit Harry, rekord shitjesh në Mbretërinë e Bashkuar

LONDËR, 11 JANAR - Libri i kujtimeve i Princit Harry, i titulluar "Spare", u bë libri më i shitur ndonjëherë në Mbretërinë e Bashkuar, tha botuesi i librit.

Libri u publikua të martën pas disa ditësh intervista televizive të Harryt dhe një versioni të publikuar gabimisht të memoarit ku u zbuluan informacione intime rreth familjes mbretërore britanike.

Libri i Harryt ka tërhequr vëmendjen në mbarë botën, pasi aty ka zbuluar betejat e tij personale dhe akuzat lidhur me anëtarët e tjerë të familjes mbretërore, përfshirë edhe për babanë e tij, Mbretin Charles, njerikën Camilla dhe vëllanë e tij të madh, Princin William. "Ne e dinim se ky libër do të fluturonte, por po i tejkalon edhe pritjet tona më të mëdha", tha përmes një deklaratë Larry Finlay,

drejtor menaxhues në "Transworld Penguin Random House". "Sipas informacioneve tona, të vetmet libra që janë shitur më shumë në ditën e parë kanë qenë ata për Harry tjetër [Potter]", shtoi ai.

Botuesi i librit tha se janë shitur 400 000 kopje në ditën e parë.

Libri "Spare" ofron zbulime të fundit të bëra nga Harry dhe gruaja e tij Meghan qëkur ata u larguan nga detyrat mbretërore më 2020 dhe u transferuan në Kaliforni për të krijuar një jetë të re. Publikimi i librit pason dokumentarin e Netflixit për Princin Harry.

Familja mbretërore nuk ka komentuar lidhur me librin dhe nuk pritet që të bëjë një gjë të tillë.

Versioni në gjuhën spanjolle i librit doli në shtije gabimisht javën e kaluar në disa librari të



Spanjës.

Në libër Harry ka folur për jetën e tij pas vdekjes së nënës Princeshës Diana kur ai ishte vetëm 12 vjeç, për konsumimin e kokainës dhe drogave të tjera për të përballuar këtë humbje dhe se si ai vrau 25 luftëtarë talibanë në

kohën kur shërbeu ushtar në Afganistan.

Në libër ai, po ashtu, ka treguar për një zënkë me vëllanë e tij, William, trashëgimtarin e fronit, duke thënë se William e kishte rrëzuar atë, dhe se si të dy i ishin lutur babait të tij që të mos

martohej me Camillën.

Në intervistat para daljes në shitje të librit, Harry ka dyfishuar akuzat e tij për disa anëtarë të familjes mbretërore, përfshirë Camilla dhe William, që zbuluan informacione për gazeta e të cilat ai tha se kanë dëmtuar atë dhe gruan e tij Meghan. Publikimi i këtyre informacioneve, sipas Harry, u bë që anëtarët e familjes mbretërore ta mbronin veten dhe ta rritnin reputacionin e tyre. "Mendoj se ajo [nëna e tij Diana] do të ishte zemërthyer lidhur me faktin që William, zyra e tij, ishte pjesë e këtyre lajmeve", tha ai për "Good Morning America".

Ndërkaq, për programin 60 minuta të CBS-së, Harry tha se Camilla ka pasur një reputacion të keq te tabloidet dhe ka pasur nevojë që ta rregullojë imazhin e saj gjë që, sipas tij, e bëri atë "të rrezikshme".



# PDK-ja kërkon shkarkimin e ambasadorit Berishaj

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se prapa ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, fshihet një lidhje shumë më e thellë e pushtetit me mafinë energjetike të vendeve të rajonit. Në një konferencë për medie të mërkurën, Çitaku ka theksuar se qeveria është duke bërë përpjekje me çdo kusht që ta amnistojë këtë aferë korruptive. “Kërkojmë nga institucionet përgjegjëse që z. Berishaj ta shkarkojnë menjëherë nga detyra e ambasadorit”, ka thënë Çitaku

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 JANAR - Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, në një konferencë për medie të mërkurën, ka kërkuar hetimin dhe shkarkimin e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, pas fakteve të reja që dëshmojnë përfshirjen e tij në skandalin energjetik.

Nënkryetarja Çitaku ka thënë se është pikërisht kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ai i cili po bëhet pengesë për t'i hapur rrugë përgjegjësive dhe të vërtetës. “Prapa ambasadorit Berishaj fshihet një lidhje shumë më e thellë e pushtetit me mafinë energjetike të vendeve të rajonit. Martin Berishaj është mik i kryeministrit Kurti, i emëruar ambasador nga kryeministri Kurti dhe përballë këtij skandali, i marrë në mbrojtje direkte nga kryeministri Kurti. Por, përkundër se qeveria është përpjekur me çdo kusht që ta amnistojë këtë aferë, skandali po thellohet çdoherë e më shumë dhe ka marrë rrugë drejt shpalesës së fakteve tepër shqetësuese, të cilat jo vetëm që tejkalojnë çështjet e integritetit

diplomatik e personal, apo edhe ndjekjes penale, por të cilat sot shtrihen deri te Zyra e Kryeministrit Albin Kurti dhe implikojnë vetë shtetin e Kosovës”, ka thënë Çitaku.

Nënkryetarja Çitaku ka bërë thirrje që kjo aferë të zbardhet deri në fund, që imazhi i Kosovës si shtet të mos dëmtohet edhe më tej. “Kërkojmë nga organet e zbatimit të ligjit që ta bëjnë punën e tyre investiguese si dhe nga institucionet përgjegjëse që z. Berishaj ta shkarkojnë menjëherë nga detyra e ambasadorit”, ka thënë Çitaku. Ajo tha se që nga fillimi i prillit të vitit 2022 qeveria Kurti është munduar ta amnistojë e ta fshehtë këtë skandal. “Që nga fillimi i prillit të vitit 2022, përgjatë gjithë vitit 2022, aktualisht tash, qeveria Kurti është munduar ta amnistojë e ta fshehtë një prej skandaleve dhe aferave më të thella e më të mëdha, protagonistët të së cilës si palë i gjen mafinë energjetike të vendeve të Ballkanit si dhe një ambasador të Republikës së Kosovës, Martin Berishaj, mik i kryeministrit Kurti, i emëruar ambasador nga kryeministri Kurti dhe përballë këtij skandali, i marrë në mbrojtje direkte nga



kryeministri Kurti”, ka thënë ajo. Çitaku rikujtoi se mediet dje raportuan për të dhëna të tjera faktike që dëshmojnë se kompania GEN ka hedhur në llogarinë e ambasadorit Berishaj 1 milion e 470 mijë euro, vlera të cilat ai nuk i ka raportuar në komision. “Dje mediet kosovare raportuan për të dhëna të tjera faktike në lidhje me veprimtarinë komerciale të z. Berishaj me GEN-in, të dhëna për të cilat z. Berishaj nuk ka qenë i sinqertë gjatë paraqitjes së tij para Komisionit Hetimor. Sipas këtyre të dhënave, në llogarinë e z. Berishaj kompania GEN ka hedhur hiq më pak se 1

milion e 470 mijë euro, vlera të cilat z. Berishaj nuk i ka raportuar në komision. Paralelisht me këto të dhëna që flasin shumë, këtu kemi të bëjmë me një përpjekje të organizuar për të fshehur gjurmë. Dje pati edhe shkrime në mediet e huaja se kompania GEN, në kuadër të shpëlarjes së parave përmes kontabilitetit fiktiv, kishte financuar edhe fushata politike, duke përmendur, mes të tjerash, fushatën zgjedhore të kryeministrit Albin Kurti ku, për kohëzgjatje, periudha kur mendohet se GEN-i ka financuar këto fushata,

përfshinë periudhën kur ambasadori Berishaj kishte tërhequr mjetet e deponuara nga GEN-i në llogarinë e tij”, ka thënë Çitaku.

Ajo shtoi se një aferë e tillë i bën dëm imazhit të Kosovës në politikën e jashtme. “Një kallëzim penal nga ana e Agjencisë Kundër Korrupsionit, një aferë e thellë që i bën dëm imazhit të Kosovës, dhe vazhdimi i kësaj sage nëpër mediet ndërkombëtare edhe sot kur po flasim, nuk kanë qenë të mjaftueshme për kryeministrin Kurti, as për presidenten Osmani që ambasadorin Berishaj ta ballafaqojnë me përgjegjësi”, ka thënë Çitaku.

## Qeveria ndan 70 mijë euro për librin e William Walkerit për masakrën e Reçakut

PRISHTINË, 11 JANAR - Në mbledhjen e parë të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023, kabineti qeveritar ka marrë vendim për ndarjen e 70 mijë eurove për hulumtimin, shkrimin, editimin, përkthimin dhe shtypjen e librit të memoareve të ambasadorit William Walker rreth masakrës së 15 janarit 1999 në fshatin Reçak dhe peshës historike të kësaj ngjarjeje.

Këtë të diel bëhen 24 vjet nga masakra e Reçakut që tronditi dhe tmerroi Kosovën, por e ndërjegjësoi dhe alarmoi botën demokratike dhe diplomacinë ndërkombëtare.

Ky libër do t'i përshkruajë ngjarjet e ndërlidhura me masakrën e Reçakut, të paraqitura nga këndvështrimi i ambasadorit Walker, të treguara nga perspektiva e tij personale si shef i Misionit Verifikues të OSBE-së.







KËSHILLTARI I LARTË I DEPARTAMENTIT AMERIKAN TË SHETIT, DEREK CHOLLET, KA TAKUAR NË PRISHTINË KRERËT SHTETËRORË TË KOSOVËS

# Kosova: Angazhimi i shtuar i ShBA-së në dialog, vendimtar për të siguruar rezultat të suksesshëm

Këshilltari i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, së bashku me të dërguarin e ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe ambasadorin amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka takuar përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës me të cilët ka diskutuar për fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së dhe për procesin e dialogut me Serbinë. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë theksuar se angazhimi i shtuar amerikan në dialog me Serbinë është vendimtar për të siguruar rezultat të suksesshëm në dobi të qytetarëve të Republikës së Kosovës

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

Prishtinë, 11 janar - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion të lartë të Departamentit Amerikan të Shtetit, i udhëhequr nga zyrtari i lartë Derek Chollet, i shoqëruar nga ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, zëvendësndihmës sekretari i Shtetit, Gabriel Escobar, zëvendësndihmëssekretari i Mbrojtjes Spencer Boyer, si dhe përfaqësues të tjerë të Departamentit të Shtetit dhe Ambasadës Amerikane. Presidentja Osmani dhe Chollet kanë konfirmuar marrëdhëniet e

shkëlqyera me Shtetet e Bashkuara, aleatin kryesor të Republikës së Kosovës, si dhe janë angazhuar për fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve. Osmani ka falënderuar Chollet për angazhimin proaktiv të Shteteve të Bashkuara në procesin e dialogut, duke theksuar se angazhimi i shtuar amerikan në këtë drejtim është vendimtar për të siguruar rezultat të suksesshëm në dobi të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Presidentja Osmani ka theksuar se marrëveshja përfundimtare, e cila duhet ta ketë në qendër njohjen e ndërsjellë, ka për qëllim përmirësimin e jetës së

qytetarëve dhe arritjen e paqes së qëndrueshme dhe afatgjatë në rajon. "Kosova është e gatshme të vazhdojë, me përkushtim të plotë, të jetë palë konstruktive, e koordinuar me ShBA-në, duke bërë propozime që kontribuojnë në arritjen e një marrëveshjeje të tillë", ka deklaruar Osmani. Në takim me Chollet, presidentja Osmani bisedoi për zhvillimet e fundit në vend dhe rajon, duke potencuar aleancën dhe afërsinë e theksuar të Serbisë me Rusinë dhe rreziqet që paraqet ky raport jo vetëm për Kosovën, por edhe për aleancën euroatlantike. Osmani ka theksuar se me mbështetjen e Ruisë Serbia vazhdon të jetë forcë destabilizuese dhe kërcënim për paqe të qëndrueshme në rajon. Presidentja Osmani në takim me delegacionin e lartë amerikan konfirmoi partneritetin historik dhe të pathyeshëm në mes të ShBA-së dhe Kosovës, ndaj pikërisht kjo është një bazë e fortë për rritjen e bashkëpunimit në fushën ushtarake dhe atë ekonomike. Bazuar në nismën e saj për dialog strategjik ndërshtetëror me ShBA-në, të iniciuar formalisht nga presidentja Osmani para gjashtë muajsh, u

shpreh gatishmëria për përshejtimin e këtij procesi në përfitim të qytetarëve të të dy shteteve. Këshilltari i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, është takuar edhe me kryeministrin Albin Kurti, ku temë diskutimi edhe në këtë takim ishte bashkëpunimi Kosovë - ShBA dhe procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pas vizitës në Prishtinë, Chollet do të nisët drejt Beogradit. Njohësi i çështjeve politike, Artan Muhaxhiri, thotë se vizita e zyrtarit të lartë amerikan është e rëndësishme sa i përket dinamizimit të procesit të dialogut. "Është e qartë se kërkesa kryesore e Chollet do të jetë angazhimi më i madh, më energjik, më i mirëfilltë, më kualitativ i Qeverisë së Kosovës në dialog, sepse edhe investimet madhore amerikane në Ballkan janë të drejtuara në arritjen e marrëveshjes finale dhe gjetjen e një zgjidhjeje për krijimin e një etape të re historike", ka theksuar Muhaxhiri për "Radion Evropa e Lirë". Sa i përket Serbisë, Muhaxhiri thotë se ky shtet ka presione të mëdha nga ShBA-ja, po ashtu

edhe nga BE-ja mirëpo, sipas tij, presidenti serb Aleksandar Vuçiq po tenton që fokusin ta vendosë te "mospajtimet dhe refuzimet e Kosovës ndaj kërkesave amerikane". "Por, është absolutisht e qartë që edhe Serbia do të duhet të bëjë kompromise shumë të mëdha nëse dëshiron që të mos stigmatizohet si bllokuese e procesit dhe nëse dëshiron që të ketë të ardhme normale evropiane", thotë ai. Vizita e Chollet në Kosovë dhe Serbi vjen disa javë pas tensionimit të situatës në veri të Kosovës, që kulmoi me vendosjen e barrkadave nga grupe të serbëve lokalë në veri të shtetit për shkak të arrestimit të një ish-polici serb. Vetë Chollet deklaroi se u shpenzuan kohë në përpjekjet diplomatike në uljen e tensioneve në vend se palët të përqendroheshin në dialog. Në këtë drejtim ai ka përmendur planin franko-gjerman, apo siç po quhet së fundi edhe si plani i BE-së, që synon çuarjen përpara të dialogut drejt një marrëveshjeje përfundimtare. "Mendojmë se BE-ja ka parashtruar një drejtim të arritshëm, një drejtim të mirë. Serish do të jetë e vështirë. Do të



# Gjermania “shqyrton” kërkesën e Kosovës për pasaporta të skaduara

PRISHTINË, 11 JANAR - Qeveria Federale e Gjermanisë është duke shqyrtuar kërkesën e bërë nga ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, për ta lejuar qarkullimin e shtetasve kosovarë me pasaporta të skaduara. Sveçla e bëri këtë kërkesë për Gjermaninë më 6 janar, pasi Kosova tash e sa muaj ka telashe me sigurimin e materialit të nevojshëm për prodhimin e pasaportave. Ambasada e Gjermanisë në Kosovë ka konfirmuar për “Radion Evropa e Lirë” se e kanë pranuar këtë kërkesë. “Kërkesa aktualisht është duke u shqyrtuar nga Ministria Federale e Brendshme”, thuhet në përgjigjen e ambasadës. Nga Ambasada Gjermane kanë shtuar se kërkesa e Sveçlës është kufizuar “në lejimin e rihyrjes në Gjermani për shtetasit kosovarë që jetojnë në

Gjermani me leje qëndrimi të vlefshme dhe foshnjat me shtetësi kosovare që kanë lindur në Gjermani dhe ende nuk u është lëshuar pasaporta e Kosovës”. “Radio Evropa e Lirë” të martën publikoi rrëfimet e qytetarëve kosovarë që janë përballur me probleme të shumta në muajt e fundit në planet e tyre për udhëtim për shkak se Agjencia për Regjistrim Civil nuk ka lëshuar pasaporta përveç për raste urgjente. Nora Fetoshi, zëdhënëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, ka thënë se kompania e kontraktuar nga qeveria për furnizim me material, me të cilin prodhohen pasaportat, nuk ka arritur ta sigurojë këtë material. “Si shumë shtete të tjera, edhe ne po përballemi me vështirësi të furnizimit me materiale, vështirësi këto që i ka



shkaktuar kriza globale si dhe pandemia me Covid-19”, ka thënë Fetoshi për “Radion Evropa e Lirë”. Më 10 janar MPB-ja ka bërë me

dije se deri në fund të këtij muaji pritet të rikthehet furnizimi me material për prodhimin e pasaportave. Në këtë njoftim MPB-ja ka thënë se “shpreh

keqardhje për situatën e krijuar dhe kërkon mirëkuptim nga të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës deri në zgjidhjen e kësaj çështjeje”.

## Aliu: Deri më 2030 presim që 30 për qind e veturave në Kosovë të jenë elektrike



PRISHTINË, 11 JANAR - Ministri i Mjedisit dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka thënë se pret që deri në vitin 2030 importimi i veturave të jetë elektrike. Aliu në një konferencë për medie të mërkurën, duke prezantuar koncept-dokumentin për Fushën e Automjeteve dhe Strategjinë e Transportit Multimodal për vitet 2023-

2030, është shprehur se deri në këtë vit diku 30 për qind e flotës e automjeteve në Kosovë të janë elektrike dhe hibride. “Dokumenti tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me fushën e automjeteve, i cili është i lidhur me Strategjinë Multimodale, e që ka të bëjë që veturat që do të importohen në vendin tonë të janë konform standardeve

teknike të sigurisë, por edhe konform standardeve të mbrojtjes së mjedisit. Sipas këtij koncepti synohet që t’i kushtohet rëndësi importimit të veturave elektrike, në mënyrë që deri në vitin 2030 diku 30 për qind e flotës e automjeteve në vend të janë elektrike dhe hibride”, ka thënë ministri Aliu.



dojë shumë punë. Do të dojë vendime të vështira dhe kurajë nga udhëheqësit, që t’i lënë mënjandë ndasitë dhe të bëjnë atë që është në interesin më të mirë të vendit të tyre”, ka deklaruar Chollet në një intervistë për

“Zërin e Amerikës” të dhënë më 6 janar. Zyrtarët në ShBA janë shprehur se prioritet për ta është formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, për të cilin Kosova dhe Serbia kanë arritur

dy marrëveshje më 2013 dhe më 2015. Edhe evropianët kanë kërkuar që Kosova ta zbatojë marrëveshjen për Asociacionin, teksa njohësi i çështjeve politike, Artan Muhaxhiri, thotë se pa nisur së trajtuar këtë temë “nuk

mund të ketë ndonjë avancim kuptimplotë në dialog”. Pavarësisht prej kërkesave të ShBA-së, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është shprehur kundër një asociacioni njëetnik. Por, Muhaxhiri thotë se Kosova

nuk ka shumë alternativa dhe se duhet të pranojë një zgjidhje edhe nëse përfshihet asociacioni në të. “Gjithsesi edhe Kosova duhet të bëjë kompromise në mënyrë që të shkohet përpara”, ka theksuar Muhaxhiri.



## Osmani vlerëson mbështetjen e Malit të Zi për perspektivën evropiane të Kosovës

PRISHTINË, 11 JANAR - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të mërkurën në takim të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Malit të Zi në Kosovë, Bernard Çobaj. Në takim presidentja Osmani ka theksuar rëndësinë e thellimit të mëtutjeshëm të raporteve të mira fqinjësore në dobi të qytetarëve dhe bashkërendimin e qëndrimeve kundër tendencave

destabilizuese në rajon. Siç njofton Presidenca, palët diskutuan për zhvillimet e fundit në vend, me ç'rast Osmani vlerësoi lart mbështetjen e Malit të Zi për perspektivën evropiane të Kosovës dhe theksoi rëndësinë e lartë të vazhimit të kësaj mbështetje përderisa Kosova po ndërmer hapa të rëndësishëm në këtë drejtim. Duke folur për rolin e

komunitetit malazez në Kosovë, presidentja Osmani potencoi bashkëpunimin e mirëfilltë në kuadër të Këshillit Konsultativ për Komunitete. Palët diskutuan për mundësitë dhe potencialin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme, me ç'rast u theksua përkushtimi i dyanshëm për angazhim drejt hapjes së kapitujve të ri të bashkëpunimit.



## Me ekspozitë fotografish dhe programe artistike, kujtohet edicioni i parë i "Flakës së Janarit"

GJILAN, 11 JANAR - Me emërtimin e saj metaforik "Flaka e Janarit" nisi rrugëtimin e saj në shënimin e dhjetëvjetorit të vrasjes të atdhetarëve Jusuf e Bardhosh Gërvallës e Kadri Zekës e në tetëvjetorin e vrasjes së Rexhep Malës e Nuhi Berishës duke u bërë një manifestim kulturor nderimi dhe kujtimi për të gjithë ata që kanë bërë sakrificën përfundimtare në shërbim të vendit të tyre.

Edicioni i parë i "Flakës së Janarit" u nis më 18 janar 1992 në trekëndëshin Bresalc-Gjilan-Përlepnice, e në nderim të kësaj, aktivitetet e ditës së parë të "Flakës..." së këtij viti kanë vazhduar në Bresalc "Te Mejtepi" dhe në Përlepnice në "Shtëpinë e Kulturës", ku në kujtim të nismës së këtij manifestimi kulturor, u shfaqën: dokumentare, u ekspozuan fotografi dokumentuese dhe u dhanë programe artistike.

Në Bresalc, i pari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni tha se është tepër e rëndësishme që, përveç ruajtjes së traditës së manifestimit "Flaka e Janarit", t'i kthehemi edhe bazës edhe arsyes së organizimit të këtij manifestimi mbarëkombëtar.

Njëri ndër themelartët e këtij manifestimi, Shemi Syla, ka folur për organizimin e këtij manifestimi kulturor asokohe, duke sjell në kujtim historikun e manifestimit të "Flakës..." dhe ka vlerësuar kreun e komunës së Gjilanit që ka ndërmarrë këtë nismë për ta rikthyer në kujtesën tonë, një nismë shumë simbolike, por edhe tejet të rëndësishme të përkujtimit të heronjve dhe dëshmorëve të rënë, që ishin bartës të lëvizjes kombëtare për çlirim.



Syla ka thënë se ky ambient sado i vogël u bë vatër për të përkujtuar përmes manifestimit që mori edhe emrin "Flaka e Janarit", përherë rënien sublimë të heronjve të kombit. Po në këtë ambient u shfaqën pjesë të dokumentarit për "Flakën..." e asaj kohe, një ekspozitë me fotografi të aktiviteteve të "Flakës...", por

edhe një program artistik nga nxënësit, e një gjë e tillë, me një agjendë të njëjtë, vazhdoi edhe në Përlepnice të Gjilanit.

Në Përlepnice, nënkryetarja e komunës së Gjilanit, Leonora Morina - Bunjaku, ka thënë se manifestimi "Flaka e Janarit" mori identitet në Gjilan, por edhe i dha identitet Gjilanit. Ndërsa Hydajet Hyseni, një ndër

themeluesit e këtij manifestimi, ka thënë se sot na ka bashkuar manifestimi "Flaka e Janarit", që është "Flakë" e dëshmorëve që kanë rënë në janar. Ai tha se janari është acar që ngrinë, por që di të përçojë e të japë flakë dhe se dëshmorët tanë ishin vetë flakë, ishin vetë zjarr, dhe ajo që mund të thuhet simbolikisht, është misioni i tyre për ta ruajtur

flakën e lirisë, për t'ua bartur brezave këtë flakë lirie.

Po ashtu, një ndër themelartët e këtij manifestimi, Bujar Nevzati, ka evokuar kujtime nga organizimi i këtij manifestimi ndër vite, duke i vlerësuar të gjithë ata që kanë kontribuar në themelimin, por edhe në organizim të "Flakës..." ndër vite.

## Policia arreston një person në Podujevë, vodhi gjësende në vlerë mbi 1 200 euro

PODUJEVË, 11 JANAR - Një ditë më parë nga zyrtarët policorë të stacionit të Podujevës është arrestuar një person për të cilin ekziston dyshimi i arsyeshëm se është përfshirë në një rast të vjedhjes së rëndë që ka ndodhur në rrugën "Xhemal Mustafa" në

Podujevë. Personi, i cili dyshohet se gjatë natës së kaluar me forcë kishte depërtuar brenda një lokali, ku ka marrë gjësende në vlerë rreth 1 250 euro, është arrestuar në flagrancë nga policia. Personi i dyshuar A. H.,

mashkull, 37 vjeç, është dërguar në mbajtje.

I njëjti për veprën vjedhje e rëndë dhe disa vjedhje të tjera ku dyshohet të jetë i përfshirë, do të intervistohet sot për shkak se, pas bërjes së testit, mbrëmë ka rezultuar i dehur.





# Rama me liderët shqiptarë të Maqedonisë: Qoftë një vit i mbarë për shqiptarët!

**TIRANË, 11 JANAR** - Kryeministri shqiptar Edi Rama ka takuar në Tiranë liderët e partive politike shqiptare të Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i këtij takimi, që ka nxitur reagime të shumta në Shkup, nuk është bërë me dije nga kreu i qeverisë shqiptare. Ai postoi një fotografi në rrjetin social "Facebook" mbi të cilën ka shkruar: "Qoftë një vit i mbarë për të gjithë shqiptarët kudo që janë".

Por, kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, tha se të gjitha temat janë "fitimprurëse", ndërsa takimin e quajti "vëllazëror". "Takimi është miqësor, vëllazëror. Do t'i shohim temat. Të gjitha temat që janë fitimprurëse. Më intereson veçanërisht ndërtimi dhe forcimi i strategjisë së përbashkët për afrimin e rrugës drejt Bashkimit Evropian. Ky është një mision jashtëzakonisht i rëndësishëm për vendin tonë. Forcimi i paqes, stabilitetit dhe progresit të ekonomisë", ka deklaruar ai. Në takim morën pjesë edhe kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Arben Taravari; kryetari i Alternativës, Afrim Gashi dhe kryetari i PDSH-së, Menduh Thaçi.

Ftesa është refuzuar nga kryetari i Lëvizjes "Besa", Bilall Kasami, pasi nuk ka dashur të

ulet në një tryezë me Ali Ahmetin, të cilin e akuzon për krim të organizuar, korrupsion, largim të shqiptarëve nga Maqedonia e Veriut dhe dështime të tjera.

Në një prononcim për mediet në Tiranë, Kasami ka thënë se takimi është në "shërbim" të BDI-së dhe jo të çështjeve të tjera. "E refuzojmë që të jemi pjesë e këtij takimi sepse vlerësojmë se ky takim nuk u shërben shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, por më shumë i shërben lidërshiptit të Bashkimit Demokratik për Integrim, parti e shqiptarëve në qeveri për më shumë se 20 vjet". "Ne vlerësojmë se takimi është thirrur shkaku i turbulencave të fuqishme brenda këtij subjekti politik, ku funksionarë të lartë të saj... kanë dalë hapur kundër lidërshiptit të partisë. Një situatë e palakmueshme për BDI-në dhe për ta defokusuar opinionin në Maqedoninë e Veriut, vlerësojmë se zhvillohet ky takim në Tiranë", tha ai.

Lidhur me takimin e Ramës me liderët shqiptarë kanë reaguar edhe partitë politike maqedonase.

Për Lidhjen Social-Demokrate në pushtet (LSDM) "Edi Rama është mik i dëshmuar i Maqedonisë (së Veriut) dhe i popullit maqedonas, ndërsa



me Shqipërinë nuk kemi çështje të hapura. Andaj, çdo takim, formal apo joformal, që është në interes të të dyja vendeve dhe të dy popujve, është për ne në drejtim të ndërtimit të një rajoni evropian".

VMRO DPMNE-ja, që është në opozitë, vlerëson se takimi në Tiranë bëhet me kërkesë të LSDM-së, e cila, sipas nënkryetarit të VMRO-së, Aleksandër Nikollovski, "është në panik për rrëzimin e

qeverisë dhe dështimin e ndryshimeve në Kushtetutë. "LSDM-ja dhe Dimitar Kovaçevski po kërkojnë ndihmë për të shpëtuar, andaj edhe janë të gatshëm të pranojnë gjithçka në dëm të popullit maqedonas përmes agjendave të ndryshme vetëm që ta shpëtojnë veten e tyre", ka deklaruar Nikollovski.

Liderët e partive politike shqiptare një takim të tillë me Ramën e kishin realizuar më 7 janar të vitit 2017, ku përmes

një deklaratë të përbashkët thanë se "angazhoheshin për ngritjen e statusit të shqiptarëve në Maqedoni në popull shtet-formues, me gjuhë zyrtare, e cila do ta kishte statusin e barabartë me gjuhën maqedonase dhe zgjidhjen e shumë çështjeve të tjera etnike".

Por kjo deklaratë nga opinioni maqedonas ishte quajtur si "Platforma e Tiranës" që, sipas tyre, kishte për synim rrënimin e shtetësisë maqedonase.

## Kurti: Projektligji për investime të qëndrueshme ka synim mbrojtjen dhe tërheqjen e investimeve

**PRISHTINË, 11 JANAR** - Kryeministri Albin Kurti ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e 118 të kabinetit qeveritar, të parën për këtë vit. Kurti ka thënë se po fillojnë edhe një vit të ri, por në të njëjtën kohë po i afrohen përmbylljes së edhe një viti të qeverisjes. "Angazhimi, puna dhe rezultatet në vitin 2022 duhet të jenë minimumi i angazhimit, punës dhe rezultateve të vitit 2023. Le ta vazhdojmë garën me veten, me bindjen se potenciali ynë është më i madh sesa aktualiteti që e kemi. Ia kemi filluar mbarë, që në ditën e tretë të vitit, e para se të mbërrijmë në gjysmën e mandatit tonë, realizuam premtimin për shtesa për të gjithë fëmijët nën moshën 16-vjeçare", ka deklaruar kryeministri.

Kurti ka thënë se sot, në javën e dytë e në mbledhjen e parë për këtë vit, patën në rend të ditës miratimin e Projektligjit

për Investime të Qëndrueshme. "Nëpërmjet tij synojmë që t'i mbrojmë dhe tërheqim investimet, vendosim bazën për ta përkrahur industrinë vendore dhe punësimin e qëndrueshëm, ta fuqizojmë rininë dhe gratë, si dhe ta thellojmë bashkëpunimin me mërgatën tonë. Me mbrojtjen, ekonominë, demokracinë dhe shtetin ligjor në binar, si dhe me buxhetin për këtë vit tashmë të miratuar në Kuvend, në vitin 2023 kemi hyrë me më shumë siguri, me më shumë besim për të ardhmen, të cilën e synojmë dhe të ardhmen të cilën e meritojmë. Zelli dhe angazhimi ynë për ta realizuar programin qeverisës dhe për t'i jetësuar reformat e thella e transformuese nuk do të pushojë as edhe për një ditë", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se viti 2023 do të jetë më shumë për arsimin, shëndetësinë, ushtrinë, bujqësinë, ekonominë e



kulturën. "Pra, do të jetë vit i edukimit, shëndetit, barazisë, drejtësisë, mirëqenies, sigurisë, prodhimit dhe zhvillimit

ekonomik e shoqëror, vit i të gjithë qytetarëve dhe për Republikën. Sfidave do t'u japim përgjigje. Vështirësitë do t'i

kthejmë në mundësi. E përballja me to do të na definojë si popull, si shoqëri e si shtet", ka thënë kryeministri Kurti.



# Ekonomia globale parashikohet të rritet për 1.7 për qind në vitin 2023

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 JANAR - Rritja globale po ngadalësohet ndjeshëm përballë inflacionit të ngritur, interesave të larta, rënies së investimeve dhe çrregullimeve që ka shkaktuar pushtimi i Ukrainës nga Rusia, sipas raportit të fundit të Bankës Botërore Perspektivat Ekonomike Globale.

Për shkak të kushteve ekonomike të brishta, çdo zhvillim i ri i pafavorshëm siç është inflacioni më i lartë sesa që është pritur, ngritjet e papritura të interesave për ta frenuar atë, rishfaqja e pandemisë Covid-19 ose përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike mund ta shtyjë ekonominë globale në recesion. Kjo do ta shënonte herën e parë që më shumë se 80 vjet që dy recesione globale ndodhin brenda të njëjtës dekadë.

Ekonomia globale parashikohet të rritet për 1.7 për qind në vitin 2023 dhe 2.7 për qind në vitin 2024.

Rënia e shpejtë e rritjes pritet të jetë e përhapur, ndërsa parashikimet për vitin 2023 ulen për 95 për qind të ekonomive të avancuara dhe gati 70 për qind të tregjeve me zhvillim mesatar dhe ekonomive në zhvillim.

Gjatë dy vjetëve të ardhshme, rritja e të ardhurave për kokë banori në tregjet në zhvillim dhe ekonominë në zhvillim parashikohet të jetë mesatarisht 2.8 për qind, një pikë përqindjeje e plotë më e ulët se mesatarja e viteve 2010-2019.

Në Afrikën Subsahariane, e cila përbën rreth 60 për qind të të varfërve të skajshëm në botë - rritja e të ardhurave për kokë banori gjatë viteve 2023-2024 pritet të jetë mesatarisht vetëm 1.2 për qind, normë kjo që mund të shkaktojë rritje e jo ulje të shkallëve të varfërisë. "Krizë me të cilën përballet zhvillimi po shtohet, ndërsa perspektiva e rritjes globale po përkeqësohet", ka theksuar presidenti i Grupit të Bankës Botërore, David Malpass. Ai ka theksuar se vendet me zhvillim mesatar dhe ato në zhvillim po përballen me një



periudhë shumëvjeçare të rritjes së ngadaltë, të shkaktuar nga ngarkesat e rënda të borxhit dhe investimet e dobëta, përderisa kapitali global po absorbohet nga ekonominë e avancuara, të cilat po përballen me nivele jashtëzakonisht të larta të borxhit qeveritar dhe me norma të interesit në rritje.

Malpass ka pohuar se zhvillimi i dobët dhe investimet e dobëta në biznes do t'i shtojnë ndryshimet tashmë shkatërruese në arsim, shëndetësi, varfëri dhe infrastrukturë dhe kërkesat në rritje për shkak të ndryshimeve klimatike.

Rritja në ekonominë e avancuara parashikohet të ngadalësohet për 2.5 për qind në vitin 2022 dhe 0.5 për qind në vitin 2023.

Gjatë dy dekadave të fundit ngadalësimet e kësaj shkalle kanë paralajmëruar recesion global. Në Shtetet e Bashkuara rritja parashikohet të bjerë në 0.5 për qind në vitin 2023 - 1.9 për qind nën parashikimet e mëparshme dhe performanca më e dobët jashtë recesioneve zyrtare që nga viti 1970.

Në vitin 2023 rritja në eurozonë pritet të jetë zero për qind - një ndryshim ky rënës prej 1.9-

përqindësh. Në Kinë rritja parashikohet të jetë 4.3 për qind në vitin 2023 - 0.9 për qind nën parashikimet e mëparshme.

Duke e përjashtuar Kinën, rritja në tregjet në zhvillim dhe ekonominë në zhvillim pritet të ngadalësohet nga 3.8 për qind në vitin 2022 në 2.7 për qind në vitin 2023, duke e pasqyruar një kërkesë të jashtme dukshëm më të dobët, të shoqëruar me inflacion të lartë, zhvlerësim të valutës, kushte më të shtrënguara për financim dhe pengesa të tjera të brendshme. Deri në fund të vitit 2024 nivelet e BPV-së në ekonominë me zhvillim mesatar dhe ato në zhvillim do të jenë afërsisht 6 për qind nën nivelet që janë pritur para pandemisë. Edhe pse inflacioni global pritet të zbutet ai do të mbetet mbi nivelet para pandemisë.

Në raport ofrohet vlerësimi i parë gjithëpërfshirës i perspektivës afatmesme për rritjen e investimeve në tregjet me zhvillim mesatar dhe ekonominë në zhvillim. Gjatë periudhës 2022-2024 investimet bruto në këto ekonomi ka të ngjarë të rriten për afro 3.5 për qind mesatarisht më pak se gjysma e normës që ka mbizotëruar në dy

dekadat e mëparshme.

Në raport është paraqitur një meny e opsioneve për politikëbërësit për ta përshpejtuar rritjen e investimeve. "Investimi i ulët është shqetësim serioz, sepse shoqërohet me produktivitet dhe tregti të dobët dhe i zbeh perspektivat ekonomike të përgjithshme. Pa rritje të fortë dhe të qëndrueshme të investimeve është thjesht e pamundur të bëhet përparim kuptimplotë në arritjen e qëllimeve zhvillimore dhe klimatike më të gjera", ka theksuar Ayhan Kose, drejtor i Grupit të Perspektivave të Bankës Botërore, duke shtuar se: "Politikat kombëtare për t'i dhënë shtysë rritjes së investimeve duhet t'u përshtaten rrethanave të vendit, por ato përherë fillojnë me krijimin e kornizave të shëndosha të politikave fiskale dhe monetare dhe ndërmarrjen e reformave gjithëpërfshirëse në klimën e investimeve".

Në raport, po ashtu, hidhet dritë mbi dilemën e 37 shteteve të vogla e shteteve me popullsi prej 1.5 milion banorëve ose më pak. Këto shtete kanë pësuar recesion më të rreptë për shkak

të Covid-19 dhe rimëkëmbje shumë më të dobët se ekonominë e tjera pjesërisht për shkak të çrregullimeve të zgjatura ndaj turizmit.

Në vitin 2020 prodhimi ekonomik në shtetet e vogla ka rënë për më shumë se 11 për qind shtatë herë më shumë sesa rënia në ekonominë e tjera me zhvillim mesatar dhe në zhvillim.

Në raport konstatohet se shtetet e vogla shpesh pësojnë humbje që ndërlidhen me katastrofat dhe që mesatarisht e arrijnë 5 për qind të BPV-së në vit. Kjo shkakton pengesa tejet të mëdha për zhvillim ekonomik. Politikëbërësit në shtetet e vogla mund t'i përmirësojnë perspektivat e rritjes afatgjatë duke e forcuar qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, duke e nxitur diversifikimin ekonomik efektiv dhe duke e përmirësuar efikasitetin e qeverisë. Në raport komunitetit global i bëhet thirrje që shteteve të vogla t'u ndihmojë duke e ruajtur fluksin e ndihmës zyrtare për ta mbështetur përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe për të ndihmuar në rikthimin e qëndrueshmërisë ndaj

## Qeveria propozon zgjatjen e masave emergjente të energjisë elektrike edhe për 30 ditë



PRISHTINË, 11 JANAR - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim t'i zgjasë masat emergjente të energjisë elektrike edhe për 30 ditë. Sipas arsytimit të qeverisë, kjo zgjatje po bëhet për rrezikun e rritjes së çmimit të energjisë në bursat ndërkombëtare. "Duke qenë se furnizimi me energjitike

mund të ketë rreziqe me rritjen e çmimeve gjatë këtyre muajve në bursat ndërkombëtare, propozojmë që të vazhdoen këto masa emergjente. Obligohen KEDS-i, KEK-u dhe institucionet për mbarëvajtjen e furnizimit me energji elektrike", ka thënë ministrja e Ekonomisë, Artane

Rizvanolli.

Ditë më parë Rizvanolli së bashku me kryeministrin Albin Kurti kishin bërë thirrje për kursimin e energjisë elektrike. Në një videomesazh ata kanë thënë se dy muajt e këtij viti janë kritikë në përballje me krizën energjetik.



# Lindja e një rendi të ri botëror energjetik



Nga Rana FOROOHAR  
"Financial Times"

Në ditën e Shën Valentinit të vitin 1945, presidenti amerikan Franklin Delano Roosevelt takoi mbretin saudit Abdul Aziz Ibn Saud në bordin e kryqëzorit amerikan "USS Quincy". Ishte fillimi i njëjës prej aleancave më të rëndësishme gjeopolitike të 70 viteve të fundit, në të cilën siguria e ofruar nga SHBA-ja në Lindjen e Mesme, shkëmbehej me naftën e blerë me dollarë.

Por kohët ndryshojnë, dhe 2023-shi mund të mbahet mend si viti kur ky pazar i madh nisi të ndryshonte, pasi po merr formë një rend i ri botëror energjetik midis Kinës dhe Lindjes së Mesme. Ndërsa Kina prej disa muajsh po blen një sasi në rritje të naftës dhe gazit nga Irani, Venezuela, Rusia dhe pjesë të Afrikës me monedhën e saj, takimi i presidentit Xi Jinping me udhëheqësit e Këshillit të Bashkëpunimit Saudit dhe Gjirit në dhjetor të vitit të kaluar, shënoi "lindjen e petro-juanit", siç shprehet në një artikull analist i "Credit Suisse" Zoltan Pozsar.

Sipas Pozsar "Kina dëshiron të rishkruajë rregullat e tregut global të energjisë", si pjesë e një përpjekjeje më të madhe për të dedollarizuar të ashtuquajturat vende të BRIC, Brazili, Rusia, India

dhe Kina dhe shumë pjesë të tjera të botës, pas përdorimit si një armë të rezervave valutore në dollarë menjë herë pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë? Si fillim, një pjesë shumë më e madhe e të tregtisë së naftës do të bëhet përmes juanit kinez (renminbi). Xi njoftoi se gjatë 3-5 viteve të ardhshme, Kina do të rrisë jo vetëm në mënyrë dramatike importet nga vendet e Gjirit, por do të punojë drejt një "bashkëpunimit energjetik gjithëdimensional".

Kjo mund të përfshijë potencialisht eksplorimin dhe prodhimin e përbashkët në vende të tilla si Deti i Kinës Jugore, si dhe investime në rafineri, në industrinë kimike dhe të plastikës. Pekini shpreson që e gjithë kjo veprimtari tregtare e shtuar të paguhet në renminbi, në Bursën e Naftës dhe Gazit Natyror të Shangait, duke nisur që nga viti 2025.

Kjo do të sillte një ndryshim të madh në tregtinë globale të energjisë. Siç e thekson edhe Pozsar, Rusia, Irani dhe Venezuela përbëjnë 40 për qind të rezervave të naftës në botë, dhe të gjitha po i shesin naftë Kinës me një ulje të madhe të çmimit.

Vendet e Gjirit përmbajnë 40 për qind të rezervave të provuara. Pjesa e mbetur prej 20 për qind i përket Afrikës Veriore dhe

Perëndimore dhe Indonezisë, rajone brenda orbitës ruse dhe kineze. Ata që dyshojnë në ngritjen e petro-juanit dhe në dobësimin e sistemit financiar të bazuar në dollarë në përgjithësi, theksojnë shpeshherë se Kina nuk gëzon të njëjtin nivel të besimit global, sundimit të ligjit apo likuiditetit të monedhës rezervë që gëzon SHBA, dhe kjo bën që vendet e tjera të mos dëshirojnë të bëjnë biznes në renminbi.

Ndoshta sepse tregu i naftës dominohet nga vende që kanë më shumë të përbashkëta me Kinën (të paktën sa i përket ekonomive të tyre politike) sesa me SHBA-në. Për më tepër, kinezët kanë ofruar një rrjet sigurie financiare, duke e bërë renminbin të konvertueshëm në ar në bursat e arit të Shangait dhe Hong Kongut.

Ndërsa kjo nuk e bën renminbin një zëvendësues të dollarit si monedhë rezervë, tregtia me petro-juanin sjell pasoja të rëndësishme ekonomike dhe financiare për politikë-bërësit dhe investitorët. Mbi të gjitha, perspektiva e energjisë së lirë po i josh tashmë bizneset industriale perëndimore të investojnë në Kinë. E tillë është lëvizja e fundit e gjigant gjerman të industrisë kimike BASF për të zvogëluar përmasat e fabrikës së saj kryesore në Ludwigshafen dhe për t'i zhvendosur operacionet në Zhanjiang. Ky mund të jetë fillimi i

asaj që Pozsar e quan tendencë "nga fermë në tryezë", në të cilën Kina përpiqet të kapë më shumë prodhim me vlerë të shtuar në vend, duke përdorur si joshje energjinë e lirë.

Edhe një numër prodhuesish evropianë kanë shtuar vendet e punës në SHBA për shkak të kostove më të ulëta të energjisë atje. Por petro-politika vjen si me rreziqe financiare po ashtu edhe me avantazhe. Vlen të kujtohet se riciklimi i petro-dollarëve nga vendet e pasura me naftë në tregjet në zhvillim si Meksika, Brazili, Argjentina, Zaire, Turqia dhe nga bankat tregtare amerikane nga fundi i viteve 1970 e në vazhdim, shkaktoi disa kriza borxhi në tregjet në zhvillim.

Ndërkaq petro-dollarët e përshpejtuan krijimin e një ekonomie më spekulative dhe të nxitur nga borxhet në SHBA, pasi bankat e mbushura me para të gatshme krijuan të gjitha llojet e "risive" të reja financiare dhe një fluks i kapitalit të huaj i dha mundësi SHBA-së të ruante një deficit më të madh.

Tani kjo tendencë mund të fillojë që të kthehet në drejtimin e kundërt. Tashmë, ka më pak blerës të huaj për bonon e thesarit të SHBA-së. Nëse forcohet petro-juani, kjo do të ushqente ndjeshëm kursin e de-dollarizimit të ekonomisë globale.

Kontrulli i më shumë rezervave

energjetike nga Kina dhe i produkteve që burojnë prej tyre, mund të jetë një kontribues i ri i rëndësishëm në inflacionin e ekonomive në Perëndim. Ky është një problem që përparon ngadalë, por ndoshta jo aq sa mendojnë disa pjesëmarrës të tregut.

Dhe çfarë duhet të bëjnë në këto kushte politikë-bërësit dhe drejtuesit e biznesit? Nëse do të isha drejtuese e një kompanie shumëkombëshe, do të kërkoja të rajonalizoj dhe lokalizoj sa më shumë që të jetë e mundur prodhimin për ta mbrojtur atë kundër një tregu energjetik shumëpolar.

Po ashtu do të zhvilloja një integrim vertikal më të madh për të kompensuar rritjen e inflacionit tek zinxhirët e furnizimit. Në rast se do të isha një politikë-bërës e SHBA-së, do të mendoja mbi mënyrat më të mira për të rritur prodhimin e naftës argjilore në Amerikën e Veriut në periudhën afatshkurtër dhe atë afatmesme (dhe t'ua ofroja evropianëve me ulje çmimi), duke e përshpejtuar edhe tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër.

Kjo është një tjetër arsye se përse evropianët nuk duhet të ankohen për Aktin e Reduktimit të Inflacionit, që subvencionon prodhimin e energjisë së pastër në SHBA. Rritja e petro-juanit duhet të jetë një nxitje për SHBA-në dhe Evropën që të distancohen sa më shpejt nga karburantet fosile.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Tre skitarë përfaqësojnë Kosovën në EYOF dimëror 2023

**PRISHTINË, 11 JANAR** - Tre skitarë të skijimit alpin do ta përfaqësojnë Kosovën në Festivalin Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF), që prej 21-28 janar 2023 mbahet në rajonin Friuli, Venezia dhe

Giulia të Italisë. Skitarët janë: Lirika Deva, Enxhi Sefaj dhe Klos Vokshi, të cilët do të garojnë në disiplinat e sllallomit dhe sllallomit të madh. Trajnerë të tyre janë Kushtrim Deva dhe Ernest

Sefaj, ndërsa shef i misionit për EYOF dimëror 2023 është Jeton Rudari. Për Kosovën është kjo pjesëmarrja e katërt në EYOF Dimëror, pas Erzurum 2017, Sarajeva 2019 dhe Vuokatti 2022.



# Prishtina bën dy goditje brenda ditës

Jalen Miller Blesa dhe Agron Kolaj janë dy përforcimet më të reja nga skuadra e Prishtinës. Sulmuesi amerikan ka shkëlqyer me fanellën e Rahovecit në Ligën e Parë dhe synon që të njëjtën gjë ta bëjë edhe në Superligë me klubin "bardhekaltër", derisa portieri Kolaj pas një përvoje në disa klube të tjera kosovare tash e tutje do ta dërsitë fanellën e klubit më të madh në vend



## Jashari përforcon Lirinë

Skuadra e Lirisë së Prizrenit ka vazhduar përforcimet për sezonin pranveror. Futbollisti më i ri i kësaj skuadre është qendërmbrojtësi Dardan Jashari i cili ka qenë pjesë edhe e Llapit, Ballkanit, Ferizajt, Malishevës dhe Flamurtarit. "Jam i lumtur për arrijten e marrëveshjes. Liria është klub me traditë. Do ta jap maksimumin për ta arritur objektivin, kthimin në elitë", ka thënë Jashari. Ndërsa drejtori Enis Gashi ka deklaruar: "Ne ende do të sjellim futbollistë. Jashari është një nga objektivat që patëm. Ditët në vijim do të ketë risi të tjera".

pikë, 11 pikë me pak se Drita dhe Ballkani që kryesojnë renditjen tabelore.

### **EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 11 JANAR** - E mërkura ka qenë ditë e mirë për FC Prishtina, pasi klubi kryeqytetas ka kryer dy goditje në afatin kalimtar duke transferuar dy futbollistë mjaftë cilësorë. Bëhet fjalë për sulmuesin Jalen Miller Blesa, i cili është amerikan, por i lindur në Barcelonë dhe është vetëm 21-vjeçar. Sulmuesi në fjalë ka shkëlqyer në Ligën e Parë të Kosovës në futboll, ku për Rahovecin realizoi 10 gola në 12 ndeshje dhe kjo bëri që ai të bie në sytë e klubit më të madh në vend. Blesa gjatë karrierës së tij është

paraqitur edhe për Istogun dhe Arlesey Town FC. Ai ka folur për faqen e klubit ku ka shprehur besimin se do të luajë me Prishtinën në Evropë. "Jam shumë i lumtur që i jam bashkuar Prishtinës që është klubi më i madh në Kosovë. Është nder të luaj për këtë ekip. Synimet me Prishtinën janë që të bëj më të mirën për ekipin dhe të luajmë në Evropë. Prishtinën e kam përcjellë gjatë periudhës që jam në Kosovë dhe mendoj se e ka një skuadër shumë të mirë", ka thënë Blesa. Goditja e dytë e prishtinasve ishte portieri Agron Kolaj. 21-vjeçari vjen si lojtar i lirë te Prishtina teksa në të kaluarën ka mbrojtur portën

e klubeve si KF Gjakova, Dukagjini Gjakovë, Besa e Pejës dhe FC Llapi. Po ashtu, portieri shtatlartë ka qenë pjesë edhe e grupmoshave të reja të Përfaqësueses së Kosovës, U-19 dhe U-21. "Jam shumë i lumtur që u bëra pjesë e Prishtinës. Vendimi për t'iu bashkuar këtij ekipi ishte shumë i lehtë duke marrë parasysh faktin se është një ndër klubet më të mëdha në Kosovë dhe rajon. Prishtina e ka bërë një projekt shumë të mirë të cilit i

besoj fuqishëm", ka thënë Kolaj. "Synimet e Prishtinës janë që të përfundojmë sa më lart në tabelë dhe të dalim në arenën ndërkombëtare. Pse jo, nëse na jepet mundësia të fitojmë edhe trofe në këtë edicion. Premtoj maksimumin tim në çdo ndeshje që do të më jepet mundësia. Shpresoj se së bashku do të kemi suksese", ka deklaruar Kolaj. FC Prishtina, që drejtohet nga Ismet Munishi, sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e tretë me 27

# Krasniqi: Përvoja e Suxhos do t'i shërbejë ngritjes së cilësisë së volejbollit



**PRISHTINË, 11 JANAR** - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Ismet Krasniqi, ka pritur trajnerin e Përfaqësueses së Kosovës U17 në volejball, konkurrenca e femrave, Donald Suxho. Suxho, që me prejardhje është nga Korça e Shqipërisë, në karrierë njihet për paraqitjet e tij me kombëtaren e ShBA-së në kampionate botërore dhe dy herë edhe në Lojërat Olimpike "Athina 2004" dhe "Londra 2012". "Presidenti Krasniqi, duke

falënderuar trajnerin Suxho për ardhjen e tij në Kosovë, theksoi se përvoja e tij në garat e nivelit të lartë do t'i shërbejë ngritjes së cilësisë së volejbollit tonë në përgjithësi dhe jo vetëm tek U-17. I pari i lëvizjes olimpike në vend i shprehu mbështetjen e lartë të KOK-ut për zhvillimin e mëtejshëm të volejbollit, por edhe sportit në përgjithësi. Nga ana e tij, trajneri Suxho shprehu admirimin e tij për pritjen e bërë, derisa theksoi se do të japë nga vetja gjithë potencialin e tij për ta çuar

volejbollin tonë në nivele më të larta", thuhet në njoftimin e KOK-ut. Të dyja palët bashkëbiseduan edhe për Lojërat Olimpike në të cilat Suxho ka lënë gjurmë, por edhe për sukseset e sportistëve tona, me theks të veçantë tri medaljet e arta olimpike të fituara nga xhudistet tona, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi e Nora Gjakova. Të pranishëm në takim ishin edhe drejtuesit e Federatës së Volejbollit të Kosovës, kryetari Bahri Gjinovci dhe sekretari i përgjithshëm, Valon Nikqi.

## Shkarkohet nga detyra presidenti i Federatës Franceze të Futbollit

**PARIS, 11 JANAR** - Komiteti i jashtëzakonshëm ekzekutiv i Federatës Franceze të Futbollit, në mbledhjen e mbajtur të mërkurën ka vendosur ta shkarkojë Nowl Le Graet nga detyrat e tij si president i

Federatës Franceze të Futbollit. Philippe Diallo, nënkryetar i organizatës, do të jetë ushtrues detyre në këtë pozitë. Në fillim deklarata e tij, se nëse Zinedine Zidane do ta merrte në telefon për t'i kërkuar pozicionin e

trajnerit të kombëtares së "gjelave" dhe se Le Graet nuk do t'ia hapte telefonatën, bëri që shumë yje të futbollit të replikojnë atë dhe të mbajnë anën e Zidane. Më pas, një tjetër situatë e rëndë ndodhi

kur Sonia Soudi, një agjente futbollit në Francë, deklaroi gjatë një interviste se Le Graet e ka ngacmuar disa herë seksualisht. Kjo gjë i hodhi edhe më shumë benzinë zjarrit.





## Al Nasr: Kontrata e Ronaldos nuk përfshin asgjë për Kupën e Botës

**RIYADH, 11 JANAR** - Cristiano Ronaldo mori vëmendjen e botës me transferimin e tij në Arabinë Saudite te klubi i Al-Nasr, duke firmosur një kontratë që e bën atë lojtarin më të paguar me 200 milionë

euro në sezon. Gjithashtu u përfol se ai do të bëhej edhe ambasador për të bërë të mundur që Arabia Saudite ta organizonte Botërorin në vitin 2030. Për sa i përket kësaj të fundit, ishte vetë Al-Nasr që ka

zgjedhur që të përgjigjet, duke shuar çdo spekulim dhe duke thënë se asgjë nuk është e vërtetë. "Al Nasr dëshiron që të qartësojë për mediet se kontrata e Cristiano Ronaldos me Al Nasrin nuk përfshin

asgjë për sa i përket Kupës së Botës. Fokusi i tij i vetëm është tek Al Nasri dhe të punojë me shokët e tij të skuadrës për ta ndihmuar klubin që ta arrijë suksesin", ka shkruar klubi arab.



## Chelsea paraqet Felixin

**LONDËR, 11 JANAR** - Joao Felix është lojtari më i ri i Chelseat. Sulmuesi portugez është huazuar gjashtë muaj te "Blutë e Londrës", pa të drejtë blerje kartoni në verë. "Artisti sapo mbërriti", shkroi Chelsea në faqen zyrtare në "Twitter", duke njoftuar kështu përfundimin më të fundit. Huazimi i ka kushtuar Chelseat plot 11 milionë euro, plus "Blutë e Londrës" do ta paguajnë edhe rrogën e plotë të portugezit për 6 muaj, që është rreth 7 milionë paundë. Pra, një investim gati 20 milionë euro nga Chelsea për vetëm 6 muaj.

Trajneri i ri i bluve, Graham Potter, ka pasur vështirësi në repartin e sulmit, pasi Havertz dhe Aubameyang nuk kanë treguar formë të mirë. Gjithashtu, edhe lëndimet e Pulisiqit, Sterlingun dhe Mount, kanë ndikuar në ecurinë aspak të mirë të Chelseat. Aktualisht, blutë e Londrës janë shumë larg zonës së Ligës së Kampionëve në Premierligë dhe duket thajse një mision i pamundur që ta mbyllin mes katër më të mirave. "Chelsea është një nga klubet më të mëdha në botë



dhe shpresoj që ta ndihmoj ekipin për t'i arritur objektivat. Jam shumë i lumtur të jem këtu dhe shumë i entuziazmuar që të luaj në "Stamford Bridge", ka deklaruar

Felix për faqen zyrtare të Chelsea. Kujtojmë se për Joao Felix kishte interesim edhe klubi i Arsenalit, por ky i fundit hoqi dorë shumë shpejt.

## Phoenixi mposhti kampionët, Clippersat dhe Miami synojnë 'play-off'-in

**MIAMI, 11 JANAR** - Skuadra kampione e Golden States u mund me rezultat 125-113 në fushën e saj nga Phoenixi, një përballje mes dy ekipesh që synojnë zonën "play-off". Tre lojtarë të Phoenixit realizuan mbi 20 pikë (Bridges 26 më i miri), duke i bërë të pavlefshme 29 pikët e Thompsonit për Warriorsin. Fitore të thellë korri Philadelphia, që falë 36 pikëve të Joel Embiidit, mundi me rezultat 147-116 Detroitin. Zhgënjën ekipi i Dallasit, që u mund me shifrat 143-



101 nga Clippersat. Edhe pse Luka Donçiqi realizoi 43 pikë e 11 rebounde, ato s'mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërsa Leonardi realizoi 33 pikë për Clippersat. Ekipi i Torontos mundi me rezultat 132-120 Charlotten, sfidë ku dallimin në

parket e bëri Siakam, autor i 28 pikëve. Fitore në sekondën e fundit korri Miami, që mundi me rezultat 112-111 Oklahoman (Butler 35 pikë), ndërsa Utah Jazzi, falë 32 pikëve të Clarksonit, mposhti 116-114 Clevelandin.

### REZULTATET

Philadelphia - Detroit	147-116
Miami - Oklahoma	112-111
Toronto - Charlotte	132-120
Utah Jazz - Cleveland	116-114
Golden State - Phoenix	113-125
Portland - Orlando	106-109
Clippers - Dallas	113-101

### SHKURT

#### Asllani: Jemi të lumtur për kualifikimin në fazën tjetër

Kristjan Asllani u bë protagonist në kualifikimin e Interit pas kohës shtesë ndaj Parmës. Mesfushori 20-vjeçar luajti plot 120 minuta në përballjen kundër Parmës, ndërkohë që pas sfidës u shpreh i kënaqur për paraqitjen dhe kualifikimin. "Jemi të lumtur për kualifikimin në fazën tjetër. Jam i kënaqur që u dhashë një dorë shokëve të mi të ekipit. Gjithmonë jam përpjekur të jap më të mirën time për klubin ku luaj. Ne erdhëm nga një pjesë e parë e nënshtruar, por gjithmonë e zotëruam topin. Parma u mbrojt mirë, fati ynë ishte që gjetëm golin në fund. Pas golit të pësuar ata ulën ritmin dhe gjeta më shumë hapësirë në lojë", ka deklaruar Asllani.

#### Kane, objektivi i madh i Realit për sezonin e ardhshëm

Harry Kane është objektivi i madh i Real Madridit për ta përforcuar sulmin sezonin e ardhshëm. "Los Blancos" ka kohë që do të shtojë një referencë të re në sulm dhe pasi nuk ia doli me Mbappen dhe Haalandin, futbollisti i Tottenham Hotspurit është opsioni i preferuar. Në parim, synimi i Tottenhamit ka qenë gjithmonë rinovimi i yllit të tij dhe kjo është se Antonio Conte e ka kushtëzuar vazhdimësinë e tij me qëndrimin e sulmuesit në skuadër. Megjithatë, lojtari duket i qartë në idetë e tij dhe në moshën 30-vjeçare dëshiron të nisë një aventurë të re në karrierën e tij. Reali ka kontaktuar me agentin e tij ashtu edhe me Tottenhamin dhe duke marrë parasysh që kontrata e tij përfundon në vitin 2024, është një operacion që mund të shkojë deri në 100 milionë euro.

#### Hazardi mund t'i bashkohet Arsenalit

Reali i Madridit po përpiqet të gjejë një blerës për mesfushorin belg Eden Hazard. Historia e tij në Madrid duket e mbyllur, edhe pse kontrata e tij me klubin madrilen zgjat deri në vitin 2024. Zgjidhja e halleve të Realit mund të vijë nga Premierë Liga. Sipas "mediafoot", Arsenali ka shfaqur interes në orët e fundit në lidhje me 32-vjeçarin. Sipas kësaj medie, përfaqësues të Arsenalit kanë kontaktuar me Realin për të folur në lidhje me belgun dhe një rikthim të mundshëm të tij në Londër që në janar. Ndërkaq, mediet spanjolle kanë bërë me dije se veç Arsenalit, interes për belgun e Realit kanë shfaqur dhe Al-Nasr dhe Galatasaray.

#### Mick Schumacher: S'më intereson asgjë tjetër veç Formula 1, vitin tjetër rikthehem në pistë

Pas dy vjetësh në Formula 1 si pilot i Haas, 23-vjeçari gjerman Mick Schumacher do të jetë këtë vit piloti rezervë i Mercedesit. Ai shpreson që pas këtij viti "tranzicion", të rikthehet në pistë si pilot i ndonjë skuadre tjetër, duke arritur të bindë ndonjë makinë. Djali i shtatë herë kampionit të botës ka hedhur poshtë çdo ofertë tjetër për të provuar ndonjë aventurë në kampionatet e tjera. "Të provoj ndonjë përvojë tjetër ndryshe nga ajo e Formula 1 nuk më intereson", ka thënë Mick Schumacher. "Tani që kam përjetuar sportin më të bukur të automobilizimit nuk do të kënaqem me gjërat e tjera, që janë më pak argëtuese. Këtë vit do të jem i pranishëm me Mercedesin në të gjitha garat, në mënyrë që të rikthehem në pistë vitin 2024, si pilot i ndonjë skuadre. Ky është objektivi im", ka deklaruar Mick Schumacheri.

## Neueri i lënduar, Bayerni kërkon portier

Në shtëpinë e Bayern Munchenit janë shumë të shqetësuar për dëmtimin e Manuel Neuerit. Kapiteni pësoi një frakturë në këmbë

gjatë pushimeve teksa po bënte ski, një dëmtim që mbylli përpara kohe sezonin e tij. Drejtuesit e Bayernit po bëjnë llogaritë jo vetëm për të

tashmen, për të gjetur një zëvendësues të shpejtë, por po mendojnë më gjatë se sa ky sezon, pasi tashmë Neueri nuk ofron më garanci as për të

ardhmen. Për herë të parë pas kaq shumë vjetësh, Neueri nuk është më i paprekshëm, por Oliver Kahn dhe stafi i tij po mendojnë për një

zëvendësues afatgjatë. Sipas medieve, në listën e dëshirave janë portierë si Yann Sommer, Livaković, Bono, Navas dhe "Dibu" Martinez.



"HORTIKULTURA" SH.A.  
Nr. 64  
Dt. 11.01.2023  
PRISHTINE



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-099 dhe Ligjin Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Komisioni i Aksionarëve të NPL "Hortikultura" Sh.A me datë 11.01.2023 nxjerr këtë:

## Njoftim

Njoftohen të gjithë Kandidatët e interesuar se Konkursi i shpallur me numër 3445 i datës 07.12.2022 për zgjedhjen e 4 (katër) anëtarëve në Bordin e Drejtorëve të NPL "Hortikultura" Sh.A në Prishtinë, i shpallur në Gazetën Ditore "Epoka e Re", dhe në tabelën e shpalljeve të Ndërmarrjes, vazhdohet në bazë të Vendimit numër 61 i datës 11.01.2023 të Komisionit të Aksionarëve edhe për (10) ditë kalendarike nga data 06.01.2023 deri me datë 16.01.2023. Të gjithë kandidatët të cilën kanë aplikuar në afar dhe procedurë të rregullt për këtë pozitë nuk kanë nevojë për ri-aplikim.

Komisioni i Aksionarëve të NPL "Hortikultura" Sh.A

## Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

"LABINOTI-AS" SH.P.K. me numer Unik:810116344 me seli rruga Qarkore p.n. Komuna Gjilan me bashkpronar **Ardit Syla**, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre **Makinerve ,Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:**

1. Traktor 90 HP 4x4 me kabin, klim dhe ngarkues ,
2. Mikser Fimaks 2.5 m2 me ngarkues ,
3. Prese Fimaks,
4. Freze 2.10 minos,
5. Shperndarese plehut ngurt sip orion 5 ton
6. Plug 3 rendor Alpler me profil trash,
7. Kose 165 cm,
8. Sperkatese 400 L,
9. Grebuj helicopter 3.3 m,
10. Mbjellose minos agri me 4 rende(edhe me pleh),
11. Laktofriz 500 L,
12. Energjia Solare 4 kw.

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek **LABINOTI-AS" SH.P.K. - Ardit Syla** (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorëzimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit te ftesave** per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: rruga Qarkore p.n. Komuna Gjilan  
Për Informata Shtesë tel: **+383 44 942 828** dhe në email adresën:  
**arditsyla91@gmail.com**

"HORTIKULTURA" SH.A.  
Nr. 64  
Dt. 11.01.2023  
PRISHTINE



Na osnovu Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima dopunjen i izmenjen Zakonom br. 04/L-111 i Zakonom br. 05/L-099 i Zakona br. 06/L-016 o privrednim društvima, Komisija akcionara NPL "Hortikultura" Sh.A od 11.01.2023. godine donosi sledeće:

## OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se svi zainteresovani kandidati da je Konkurs raspisan pod brojem 3445 od 07.12.2022.godine za izbor 4 (četiri) člana u Upravni odbor NPL „Hortikultura“ Sh.A u Prištini, objavljen u Dnevnom novinama „Epoka e Re“, a u oglasnoj tabeli Preduzeća, nastavlja se na osnovu Odluke broj 61 od 11.01.2023.godine Komisije za akcize za (10) kalendarskih dana, od 06.01.2023.godine do 16.01.2023. Svi kandidati koji su konkurisali za ovu poziciju u redovnom poslovanju i postupku ne moraju ponovo da konkurisu.

Odbor akcionara NPL "Hortikultura" Sh.A

## Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

"SANIJE JERLIU" B.I. me numer Unik:810334623 me seli fshati Dazhnicë p.n. Komuna Kamenicë me pronare **Sanije Jerliu**, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre **Makinerve, Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:**

1. Traktor 120 HP me Lugë, kabine dhe klime 4 x 4,
2. Rimorkio per shperndarjen e plehut organik 5 ton
3. Rotoballer 120x120,
4. Mbeshtjellse me Najllon,
5. Panela Solare 3 kw

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek **"SANIJE JERLIU" B.I.- Sanije Jerliu**, (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorëzimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit te ftesave** per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: fshati Dazhnicë p.n. Komuna Kamenicë  
Për Informata Shtesë tel: **+383 44 555 954** dhe në email adresën:  
**saniajerliu@gmail.com**



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- Nexhmedin Sylaj shpall të pavlefshme certifikatën e Aftësimit Profesional Organizim në Punë-Njohje me Pajisje dhe Vegla, Vizatim Teknik Lexim i Planit Beton.

- Agron Hapqiu shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Damir Shabani shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Behar Berisha shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Fiton Baxhaku shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe regjistrimi i vitit X instalues elektrik shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Orhan Opoja shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Florije Zatriqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari".

- Egon Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Ardolina Binaku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XIMXII dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi"

- Besim Gjgja shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Shaban Gola" Lipovec KK Gjakovë, nga kl. VI-IX.

- Nue Kita nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV të sh.m.ekonomike "Kadri Kusari.

- Ardian Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi".

- Avni Hajdari shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.

- Fesal Hyseni shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Altina Badalli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Ali Ahmetaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Vjollce Fandaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmgj " Jeta e Re " Suhareke.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULË

MEKA  
HALAL FOOD

gluten  
free



cilësi e garantuar

pa konservues